<p>shtëpiake ose pronën, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut do të kryejnë një vlerësim në lidhje me pajisjen ose pjesët lidhëse të saj, i cili mbulon të gjitha kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë Rregullore. Operatorët ekonomik përkatës duhet të bashkëpunojnë sipas nevojës me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për atë qëllim.</p> <p>2. Kur, gjatë vlerësimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut konstatojnë se pajisja ose pjesët lidhëse të saj nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore, ata duhet të kërkojnë pa vonesë nga operatori përkatës ekonomik të marrë të gjitha veprimet e duhura korrigjuese për ta sjellur pajisjen ose pjesët lidhëse të saj në përputhje me ato kërkesa, për të tërhequr pajisjen ose pjesët lidhëse të saj nga tregu, apo për ta kthyer atë brenda një periudhe të arsyeshme, në proporcion me natyrën e rrezikut, siç mund ata përcaktojnë.</p> <p>3. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të informojnë trupin e emëruar ose të notifikuar në përputhje me rrethanat.</p> <p>4. Dispozitat nga neni 49 i ligjit Nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësimin e konformitetit do të zbatohen për</p>	<p>property, they shall carry out an evaluation in relation to the appliance or fitting concerned covering all relevant requirements laid down in this Regulation. The relevant economic operators shall cooperate as necessary with the market surveillance authorities for that purpose.</p> <p>2. Where, in the course of the evaluation referred to in the first subparagraph, the market surveillance authorities find that the appliance or fitting does not comply with the requirements laid down in this Regulation, they shall without delay require the relevant economic operator to take all appropriate corrective action to bring the appliance or fitting into compliance with those requirements, to withdraw the appliance or fitting from the market, or to recall it within a reasonable period, commensurate with the nature of the risk, as they may prescribe.</p> <p>3. The market surveillance authorities shall inform the relevant notified body accordingly.</p> <p>4. Provisions from Article 49 of the Law No. 06/L-041 on Technical Requirements for Products and Conformity Assessment shall</p>	<p>za nadzor tržišta sprovede ocenjivanje o aparatu ili njegovim sastavnim delovima, koja pokriva sve odgovarajuće zahtjeve iz ove Uredbe. Odgovarajući privredni subjekti, prema potrebi, u tu svrhu sarađuju sa organima za nadzor tržišta.</p> <p>2. Kada tokom ocenjivanja navedenog u stavu 1. ovog člana, organi za nadzor tržišta ustanove da aparat ili njegovi sastavni delovi neispunjavaju zahteve ove Uredbe, oni moraju da bez odlaganja zahtevaju da odgovarajući privredni subjekt sprovede sve odgovarajuće korektivne radnje kako bi aparat ili njegove sastavne delove uskladio sa tim zahtevima, povukao aparat ili njegove sastavne delove sa tržišta ili ih opozvao u razumnom roku, u srazmeri sa prirodom rizika, kako oni to mogu utvrditi.</p> <p>3. Organi za nadzor tržišta će obavestiti imenovano ili prijavljeno telo u skladu sa okolnostima.</p> <p>4. Odredbe člana 49. Zakona br. 06/L-041 o tehničkim zahtevima za proizvode i</p>
---	--	---



<p>masat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.</p> <p>5. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura korrigjuese në lidhje me të gjitha pajisjet dhe pjesët lidhëse të saj përkatëse që ai ka vënë në dispozicion në treg.</p> <p>6. Kur operatori përkatës ekonomik nuk ndërmerr veprime adekuate korrigjuese brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut duhet të marrin të gjitha masat e duhura të përkohshme për të ndaluar ose kufizuar pajisjet ose pjesët lidhëse të tyre të vendosura në treg, për të tërhequr pajisjet ose pjesët lidhëse të tyre nga tregu ose për ta kthyer atë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Pajisjet ose pjesët lidhëse të tyre në përputhshmëri që paraqesin rrezik</p> <p>1. Kur, gjatë kryerjes së vlerësimit sipas nenit 31 paragrafi 1 i kësaj Rregullore, autoriteti kompetent i mbikëqyrjes së tregut konstaton se edhe pse pajisja ose pjesët lidhëse të saj janë në përputhje me këtë Rregullore, por paraqesin</p>	<p>apply to the measures referred to in the second subparagraph of this paragraph.</p> <p>5. The economic operator shall ensure that all appropriate corrective action is taken in respect of all the appliances and fittings concerned that he has made available on the market.</p> <p>6. Where the relevant economic operator does not take adequate corrective action within the period referred to in paragraph 2 of this Article, the competent market surveillance authorities shall take all appropriate provisional measures to prohibit or restrict the appliances or fittings being made available on the market, to withdraw the appliance or fitting from that market or to recall it.</p> <p style="text-align: center;">Article 32 Compliant appliances or fittings which present a risk</p> <p>1. Where, having carried out an evaluation under Article 31, paragraph 1 of this Regulation, the competent market surveillance authority finds that although an appliance or fitting is in compliance with this Regulation, it presents a risk to the health or safety of persons</p>	<p>ocenjivanju usklađenosti će se primenjivati na mere utvrđene u stavu 2. ovog člana.</p> <p>5. Privredni subjekt obezbeđuje da su poduzete sve prikladne korektivne radnje u vezi sa svim takvim aparatima ili njihovim sastavnim delovima koju je on stavio na raspolaganje na tržište.</p> <p>6. Kada odgovarajući privredni subjekt ne preduzme prikladne korektivne mere u periodu utvrđenom u stavu 2. ovog člana, organi nadležni za nadzor tržišta preduzimaju sve prikladne privremene mjere kako bi zabranili ili ograničili dostupnost aparata ili njihovih sastavnih delova stavljenim na tržištu, odnosno povukli aparat ili njegove sastavne delove sa tržišta ili ih opozvali.</p> <p style="text-align: center;">Član 32. Usklađeni aparati ili njihovi sastavni delovi koji predstavljaju rizik</p> <p>1. Kada se tokom sprovođenja ocene, u skladu sa članom 31. stav 1, organ nadležan za nadzor tržišta ustanovi da aparat ili njegovi sastavni delovi, iako je aparat ili njegovi sastavni delovi u skladu sa ovom Uredbom, ali predstavljaju rizik za zdravlje i bezbednost ljudi ili domaćih</p>
---	--	--



<p>rrezik për shëndetin, sigurinë e personave, kafshët shtëpiake ose pronën, do të kërkojnë nga operatori ekonomik të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që pajisja ose pjesët lidhëse të saj, kur të vendoset në treg, të mos paraqet më atë rrezik, të tërheqë pajisjen ose pjesët lidhëse të saj nga tregu apo ta kthejë atë brenda një periudhe të arsyeshme, në proporcion me natyrën e rrezikut, siç mund të përshkruhet.</p> <p>2. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të merren veprime korrigjuese në lidhje me të gjitha pajisjet ose pjesët lidhëse të tyre që i ka vënë në dispozicion të tregut.</p> <p style="text-align: center;">Neni 33 Mospërputhshmëria formale</p> <p>1. Pa paragjykuar nenin 31 të kësaj Rregullore, autoriteti kompetent i mbikëqyrjes së tregut duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që t'i eliminoj mospërputhshmëritë formale, për gjetjet e mëposhtme,:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. shënjimi CE është vendosur në kundërshtim me parimet e përgjithshme sipas nenit 16 të kësaj Rregullore;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. shënjimi CE nuk është vendosur fare;</p>	<p>or to domestic animals or property, it shall require the relevant economic operator to take all appropriate measures to ensure that the appliance or fitting concerned, when placed on the market, no longer presents that risk, to withdraw the appliance or fitting from the market or to recall it within a reasonable period, commensurate with the nature of the risk, as it may prescribe.</p> <p>2. The economic operator shall ensure that corrective action is taken in respect of all the appliances or fittings concerned that he has made available on the market.</p> <p style="text-align: center;">Article 33 Formal non-compliance</p> <p>1. Without prejudice to article 31 of this Regulation, where the competent market surveillance authority makes one of the following findings, it shall require the relevant economic operator to put an end to the non-compliance concerned:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. the CE marking has been affixed in violation of general principles according to Article 16 of this Regulation;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. the CE marking has not been affixed;</p>	<p>životinja ili imovinu, on će od odgovarajućeg privrednog subjekta zahtevati da preduzme sve odgovarajuće mere kako taj aparat ili njegovi sastavni delovi nakon stavljanja na tržište više ne predstavljaju rizik, njihovo povlačenje sa tržišta ili opoziv u razumnom roku, u srazmeri sa prirodom rizika, kako oni to mogu opisati.</p> <p>2. Privredni subjekt mora da obezbedi preduzimanje korektivnih radnji u vezi sa svim takvim aparatima ili njihovim sastavnim delovima, koje je stavio na raspolaganje na tržište.</p> <p style="text-align: center;">Član 33. Formalna neusklađenost</p> <p>1. Ne dovodeći u pitanje član 31, organ nadležan za nadzor tržišta zahteva od odgovarajućeg privrednog subjekta da ukloni neusklađenost, za sledeće nalaze:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Da je oznaka CE stavljena u suprotnosti saopštim načelima u skladu sa članom 16. ove Uredbe;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Da oznaka CE uopšte nije stavljena;</p>
---	---	--



<p>1.3. mbishkrimet e përcaktuara në Shtojcën 4 nuk janë vendosur ose janë vendosur në kundërshtim me nenin 18 të kësaj Rregullore;</p> <p>1.4. numri identifikues i trupit të notifikuar të përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit është vendosur në kundërshtim me nenin 17 të kësaj Rregullore ose nuk është vendosur fare;</p> <p>1.5. nuk është e hartuar deklarata e konformitetit të BE-së ose nuk është hartuar si duhet;</p> <p>1.6. një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së nuk është bashkangjitur me pjesët lidhëse të pajisjes;</p> <p>1.7. dokumentacioni teknik ose nuk është i disponueshëm ose nuk është i plotë;</p> <p>1.8. informacioni i përmendur në nenin 7 paragrafët 6 dhe 7 ose nenin 9 paragrafët 5 dhe 6 i kësaj Rregullore mungon, është false ose jo i plotë;</p> <p>1.9. çdo kërkesë tjetër administrative e përcaktuar në nenin 7 ose nenin 9 të kësaj Rregullore nuk është përmbushur.</p>	<p>1.3. the inscriptions referred to in Annex 4 have not been affixed or have been affixed in violation of Article 18 of this Regulation;</p> <p>1.4. the identification number of the notified body involved in the production control phase has been affixed in violation of Article 17 of this Regulation or has not been affixed;</p> <p>1.5. the EU declaration of conformity has not been drawn up or has not been drawn up correctly;</p> <p>1.6. a copy of the EU declaration of conformity does not accompany the fitting;</p> <p>1.7. the technical documentation is either not available or not complete;</p> <p>1.8. the information referred to in Article 7, paragraph 6 and 7 or Article 9 paragraph 5 and 6 of this Regulation is absent, false or incomplete;</p> <p>1.9. any other administrative requirement provided for in Article 7 or Article 9 of this Regulation is not fulfilled.</p>	<p>1.3. Da natpisi iz Priloga 4. nisu stavljeni ili su u suprotnosti sa članom 18. ove Uredbe;</p> <p>1.4. Da identifikacioni broj prijavljenog tela uključenog u fazu kontrole proizvodnje nije stavljen u skladu sa člankom 17. ili da uopšte nije stavljen;</p> <p>1.5. Da izjava EU o usklađenosti nije sastavljena ili je nepravilno sastavljena;</p> <p>1.6. Da primerak izjave EU o usklađenosti nije priložen uz sastavne delove aparata;</p> <p>1.7. Da tehnička dokumentacija nije dostupna ili je nepotpuna;</p> <p>1.8. Da nedostaju podaci iz člana 7. stav 6. ili člana 9. stavovi 5. i 6. ove Uredbe, da su netačni ili nepotpuni;</p> <p>1.9. Da nije ispunjen bilo koji drugi administrativni zahtev iz člana 7. ili članka 9 ove Uredbe.</p>
--	---	--



<p>2. Kur mospërputhshmëria sipas paragrafit 1 të këtij neni vazhdon, autoriteti kompetent i mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose ndaluar pajisjen ose pjesët lidhëse të saj që janë në dispozicion në treg ose duhet të sigurojnë që ai është kthyer apo tërhequr nga tregu.</p> <p style="text-align: center;">Neni 34 Dispozitat ndëshkuese</p> <p>Operatori ekonomik i cili shkel detyrimet sipas kësaj Rregullore ndëshkohet sipas Ligjit për Kërkesa Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</p> <p style="text-align: center;">Neni 35 Dispozitat Kalimtare</p> <p>1. Autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut nuk do të pengojnë vënien në dispozicion të tregut ose vënien në përdorim të pajisjeve sipas Rregullores Nr. 06/2012 për</p>	<p>2. Where the non-compliance referred to in paragraph 1 of this Article persists, the competent market surveillance authority shall take all appropriate measures to restrict or prohibit the appliance or fitting being made available on the market or ensure that it is recalled or withdrawn from the market.</p> <p style="text-align: center;">Article 34 Penalties</p> <p>Economic operator who violates the obligations under this Regulation shall be penalized according to the Law on Technical Requirements for Products and Conformity Assessment.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER VII TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 35 Transitional provisions</p> <p>1. Competent market surveillance authorities shall not impede the making available on the market or the putting into service of appliances covered by Regulation No. 06/2012 on Gas</p>	<p>2. Kada se neusklađenost iz stavka 1. nastavi, organ nadležan za nadzor tržišta preduzima sve odgovarajuće mere kako bi ograničio ili zabranio stavljanje aparata ili njegovih sastavnih delova na tržište ili kako bi obezbedio njihov opoziv ili povlačenje sa tržišta.</p> <p style="text-align: center;">Član 34. Kaznene odredbe</p> <p>Privredni subjekat koji krši obaveze iz ove Uredbe se kažnjava u skladu sa Zakonom o tehničkim zahtevima za proizvode i ocenjivanju usklađenosti.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE VII PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 35. Prelazne odredbe</p> <p>1. Organi nadležni za nadzor tržišta neće ometati stavljanje na tržište ili upotrebu aparata prema Uredbi br. 06/2012 o aparata na</p>
---	--	--



<p>Pajisjet me gazit, dhe të cilat janë vendosur në treg para se të hyjë në fuqi kjo Rregullore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Dispozitat e shenjës CE</p> <p>1. Dispozitat e kësaj Rregullore mbi detyrimin për vendosjen e shenjës CE në pajisje dhe në pjesë lidhëse të saj do të zbatohen që nga dita e pranimin të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.</p> <p>2. Pajisjet dhe pjesët lidhëse të saj që plotësojnë të gjitha kërkesat sipas nenit 1 të kësaj Rregullore dhe që janë shënjuar me shenjën CE, nuk pengohen kur ato vihen në dispozicion në treg për arsye se mbulohen nga kjo Rregullore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Komunikimi me BE</p> <p>Pas anëtarësimit në BE, Republika e Kosovës do t'i komunikojë Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare në përputhje me Shtojcën 2 dhe duke përdorur formularin përkatës, llojet e gazit dhe presionet përkatëse të furnizimit të karburanteve të gazta të përdorura në territorin</p>	<p>Appliances, which were placed on the market before the entry into force of this Regulation.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 CE marking provisions</p> <p>1. Provisions of this Regulation on the obligation to affix CE marking on appliances and fittings shall be applied from the day of accession of the Republic of Kosovo to the European Union.</p> <p>2. Appliances and fittings which fulfil all the requirements according to Article 1 of this Regulation and are marked with CE marking shall not be impeded, for reasons covered by this Regulation, when made available on the market.</p> <p style="text-align: center;">Article 37 Communication with EU</p> <p>After EU membership, the Republic of Kosovo shall communicate to the Commission and the other Member States in accordance with Annex 2 and using the relevant form, the types of gas and corresponding supply pressures of gaseous fuels used on their territory. It shall also communicate any changes thereof within</p>	<p>gas, a koji su na tržište stavljeni pre nego što ova Uredba stupi na snagu.</p> <p style="text-align: center;">Član 36. Odredbe oznake CE</p> <p>1. Odredbe ove Uredbe o obavezi postavljanja oznake CE na aparate i njihove sastavne delove će se primenjivati od dana pristupanja Republike Kosovo Evropskoj uniji.</p> <p>2. Aparati i njihovi sastavni delovi koji ispunjavaju sve zahteve prema članu 1. ove Uredbe i koji su označeni oznakom CE, nisu ometani kada se oni stave na raspolaganje na tržištu, zato što su obuhvaćeni ovom Uredbom.</p> <p style="text-align: center;">Član 37. Komunikacija sa EU</p> <p>Po pristupanju EU-u, Republika Kosovo će obavestiti Komisiju i ostale države članice u skladu sa Prilogom 2. i koristeći odgovarajući obrazac, vrste gasa i odgovarajuće pritiske za snabdevanje gasovitim gorivima, koji se koriste na njihovoj teritoriji. Takođe će im</p>
--	---	--



<p>e tyre. Gjithashtu, do të komunikojë çdo ndryshim të tyre brenda gjashtë muajve nga shpallja e ndryshimeve të parashikuara.</p> <p style="text-align: center;">Neni 38 Kuptimi i termave</p> <p>1. Deri në ditën e pranimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, termat e përdorur në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. »Deklarata e konformitetit të BE-së" nënkupton "deklaratën e konformitetit";</p> <p>1.2. »Certifikata për ekzaminimin e llojit e BE-së «nënkupton »certifikatën për ekzaminimin e llojit«;</p> <p>1.3. »Ekzaminimi i llojit e BE-së« nënkupton »ekzaminimi i llojit«.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Shtojcat e Rregullores</p> <p>1. Shtojcat I deri në V janë pjesë përbërese e kësaj Rregullore:</p> <p>1.1. Kërkesat Themelore;</p>	<p>six months after the announcement of the envisaged changes.</p> <p style="text-align: center;">Article 38 Meaning of terms</p> <p>1. Until the day of accession of the Republic of Kosovo to the European Union the terms used in this Regulation have the following meaning:</p> <p>1.1. »EU declaration of conformity« means »declaration of conformity«,</p> <p>1.2. »EU-type examination certificate« means »type examination certificate«,</p> <p>1.3. »EU type examination« means »type examination«.</p> <p style="text-align: center;">Article 39 Annexes to the Regulation</p> <p>1. Annexes I to V are an integral part of this Regulation:</p> <p>1.1. Basic Requirements;</p>	<p>saopštiti sve promene u roku od šest meseci od objave planiranih izmena.</p> <p style="text-align: center;">Član 38. Značenje izraza</p> <p>1. Do dana pristupanja Republike Kosovo Evropskoj uniji, izrazi korišćeni u ovoj Uredbi imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. » EU izjava o usklađenosti« znači »izjava o usklađenosti«;</p> <p>1.2. »EU potvrda o ispitivanju tipa« znači »potvrda ispitivanju tipa«;</p> <p>1.3. »Ispitivanje tipa EU-a« znači »ispitivanje tipa«.</p> <p style="text-align: center;">Član 39. Aneksi Uredbe</p> <p>Aneksi I do V su sastavni deo ove Uredbe.</p> <p>1.1. Osnovni zahtevi;</p>
---	--	---



<p>1.2. Përmbajtja e komunikimeve të Shteteve Anëtare të kushteve për furnizim me gaz;</p> <p>1.3. Procedurat e vlerësimit të konformitetit për paisje dhe pjesët lidhëse të paisjes;</p> <p>1.4. Mbishkrimet;</p> <p>1.5. Deklarata e konformitetit</p> <p style="text-align: center;">Neni 40 Shfuqizimi</p> <p>Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja nr. 06/2012 për pajisjet me gaz.</p> <p style="text-align: center;">Neni 41 Hyrja në fuqi</p> <p>Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e shtatë (7) pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p>	<p>1.2. Content of Member States' communications on gas supply conditions;</p> <p>1.3. Conformity assessment procedures for equipment and equipment fittings;</p> <p>1.4. inscriptions;</p> <p>1.5. Declaration of conformity</p> <p style="text-align: center;">Article 40 Repeal</p> <p>With effect from entering into force of this Regulation, the Regulation No. 06/2012 on Gas Appliances is repealed.</p> <p style="text-align: center;">Article 41 Entry into force</p> <p>This Regulation shall enter into force on the seventh (7) day following that of its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p>	<p>1.2. Sadržaj komunikacija država članica o uslovima za snabdevanje gasom;</p> <p>1.3. Postupci procene usklađenosti za aparate i povezane delove aparata</p> <p>1.4. Natpisi</p> <p>1.5. Izjava o usklađenosti</p> <p style="text-align: center;">Član 40. Ukidanje</p> <p>Stupanjem na snagu ove Uredbe, ukida se Uredba br. 06/2012 o aparatima na gas.</p> <p style="text-align: center;">Član 41. Stupanje na snagu</p> <p>Ova Uredba stupa na snagu sedmog (7) dana od objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p>
---	---	--



<p>Vesel KRASNIQI</p> <hr/> <p>Minister i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë</p> <p>Prishtinë, 00.02.2021</p>	<p>Vesel KRASNIQI</p> <hr/> <p>Minister of the Ministry of Trade and Industry</p> <p>Prishtina, 00.02.2021</p>	<p>Vesel KRASNIQI</p> <hr/> <p>Ministar Ministarstva trgovine i industrije</p> <p>Priština, 00.02.2021</p>
---	---	---



SHTOJCA 1

KËRKESAT THEMELORE

VLERËSIMET PARAPRAKE:

1. Kërkesat themelore të përcaktuara në këtë Rregullore janë të detyrueshme.
2. Kërkesat themelore duhet të interpretohen dhe zbatohen në atë mënyrë që të marrin parasysh gjendjen e artit avancimet teknologjike dhe praktikën aktuale në kohën e projektimit dhe prodhimit, si dhe konsideratat teknike dhe ekonomike që janë në përputhje me një shkallë të lartë të efikasitetit të energjisë dhe të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë.

1. KËRKESAT E PËRGJITHSHME

1.1. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në atë mënyrë që të funksionojnë sigurt dhe kur përdoren në mënyrë të drejtë, të mos paraqesin rrezik për personat, kafshët shtëpiake ose pronat. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që të përmbushin saktë qëllimin e tyre të synuar kur inkorporohen në një pajisje ose të montohen për të krijuar një pajisje.

1.2. Prodhuesi është i detyruar të analizojë rreziqet në mënyrë që të identifikojë ato që vlejné për pajisjen ose pjesët lidhëse të saj. Ai pastaj do ta dizajnojë dhe konstruktojë pajisjen duke marrë parasysh vlerësimin e rrezikut të saj.

1.3. Në përzgjedhjen e alternativave më të përshtatshme, prodhuesi duhet të zbatojë parimet e përcaktuara më poshtë:

- (a) eliminojë ose zvogëlojë rreziqet sa më shumë të jetë e mundur (natyrisht dizanjimi dhe konstruktimi i natyrshëm);
- (b) të marrë masat e nevojshme të mbrojtjes në lidhje me rreziqet që nuk mund të eliminohen;
- (c) informimi i përdoruesit për rreziqet e mbetura për shkak të mangësive të masave mbrojtëse të miratuara dhe të tregojnë nëse kërkohen masa paraprake të veçanta.

1.4. Me rastin e dizajnit dhe konstruktimit të pajisjes si dhe hartimit të udhëzimeve, prodhuesi duhet të parashikojë jo vetëm përdorimin e synuar të pajisjes, por edhe ndonjë përdorim të gabuar të saj që arsyeshëm mund të parashikohet.

1.5. Të gjitha pajisjet duhet të:



- (a) shoqërohen me udhëzime për instalim të destinuara për instaluesin;
- (b) shoqërohen me udhëzime për përdorim dhe servisim të destinuara për përdoruesin;
- (c) mbartin njoftimet e duhura paralajmëruese, të cilat gjithashtu duhet të paraqiten në paketim.

1.6.1. Udhëzimet për instalimin e destinuar për instaluesin duhet të përmbajnë të gjitha udhëzimet për instalim, rregullim dhe servisim të nevojshëm për të siguruar që këto veprime janë kryer si duhet, në mënyrë që pajisja të përdoret në mënyrë të sigurt.

Udhëzimet për instalim të destinuara për instaluesin duhet të përfshijnë gjithashtu informacione mbi specifikimet teknike të ndërfaqes midis pajisjes dhe mjedisit të saj të instalimit që lejojnë lidhjen e saj të saktë me rrjetin e furnizimit me gaz, furnizimin e energjisë ndihmëse, furnizimin e ajrit për djegie dhe sistemin e lirimit të gazit nga gypi.

1.6.2. Udhëzimet për përdorim dhe servisim të destinuara për përdoruesit do të përmbajnë të gjitha informacionet e kërkuara për përdorim të sigurt dhe në veçanti do të tërheqin vëmendjen e përdoruesit për çdo kufizim në përdorim.

Prodhuesit duhet të shënojnë në udhëzimet kur nevojitet kujdes shtesë ose kur do të ishte e këshillueshme që çdo punë e mësipërme të kryhet nga një profesionist. Kjo do të jetë pa paragjykuar kërkesat kombëtare për këtë qëllim.

Prodhuesi i pajisjes do të përfshijë në udhëzimet që shoqërojnë pajisjen të gjitha informacionet e nevojshme për rregullimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve lidhëse të pajisjes si pjesë të pajisjes së përfunduar, sipas rastit.

1.6.3. Njoftimet paralajmëruese për pajisje dhe paketimin e saj duhet të tregojnë qartë llojin e gazit që duhet të përdoret, presionin e furnizimit me gaz, kategorinë e pajisjes dhe çdo kufizim në përdorim, veçanërisht kufizimin me të cilin pajisja do të instalohet vetëm në zonat ku ka ventilim të mjaftueshëm për të siguruar që rreziqet e paraqitura prej saj të minimizohen.

1.7. Udhëzimet për inkorporimin e pjesëve lidhëse të pajisjes në një pajisje ose montimin e saj në mënyrë që të përbëjnë një pajisje dhe për rregullimin e saj, funksionimin dhe mirëmbajtjen do të shoqërohen me pjesët lidhëse të pajisjes si pjesë e deklaratës së konformitetit të BE-së.

2. MATERIALET

Materialet për pajisje ose për pjesë lidhëse të pajisjes duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin e tyre të destinuar dhe duhet t'i rezistojnë kushteve mekanike, kimike dhe termike ndaj të cilave pritet të jenë të ekspozuara.



3. PROJEKTIMI DHE NDËRTIMI

Detyrimet që rrjedhin për pajisjet nga kërkesat themelore të përcaktuara në këtë pikë zbatohen edhe për pjesët lidhëse, për aq sa është relevante.

3.1. Të Përgjithshme

3.1.1. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që, kur përdoren në mënyrë të drejtë, të mos kenë paqëndrueshmëri, shtrembërim, thyerje ose konsumim që mund të zvogëlojnë sigurinë e tyre.

3.1.2. Kondensimi i krijuar gjatë fillimit dhe/ose gjatë përdorimit nuk duhet të ndikojë në sigurinë e pajisjeve.

3.1.3. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e shpërthimit në rast të një zjarri nga jashtë.

3.1.4. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që nuk mund të vijë deri të depertimi i padëshiruar i ujit dhe ajrit në pjesët e transmetimit të gazit.

3.1.5. Në rast të një luhatje normale të energjisë ndihmëse, pajisjet duhet të vazhdojnë të funksionojnë në mënyrë të sigurt.

3.1.6. Luhatjet jonormale ose defektet e energjisë ndihmëse apo rikyçja e saj nuk duhet të çojë në një situatë të pasigurt.

3.1.7. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që të evitohen rreziqet që lidhen me gazin për shkak të risqeve nga energjia elektrike. Për aq sa është relevante, rezultatet e vlerësimit të konformitetit në lidhje me kërkesat e sigurisë së rregullave për Radio Pajisjet ose objektivat e sigurisë së rregullave për Pajisjet e Tensionit të Ulët do të merren parasysh.

3.1.8. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që të evitohen rreziqet që lidhen me gazin për shkak të risqeve që vijnë nga fenomenet elektromagnetike. Për aq sa është relevante, rezultatet e vlerësimit të konformitetit në lidhje me kërkesat e përputhshmërisë elektromagnetike të rregullave për radio pajisjet ose rregullat për pajtueshmërinë elektromagnetike do të merren parasysh.

3.1.9. Të gjitha pjesët nën presion të një pajisjeje duhet t'i rezistojnë streseve mekanike dhe termike të cilave i'u nënshtrohen pa ndonjë deformim që ndikon në sigurinë. Të gjitha pjesët e pajisjes të nënshtuara presionit duhet të përballojnë ngarkesat mekanike dhe termike pa pësuar asnjë deformim që mund të ndikojnë në siguri.

3.1.10. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që mosarritja e një pajisje sigurie, kontrolluese ose rregulluese të mos çojë në një situatë të pasigurt.



Pajisjet duhet të projektohen dhe konstruktohen ashtu që dëmtimi i një mjete të sigurisë, kontrollit apo rregullimit, nuk mund të shkaktojë ndonjë situatë të rrezikshme.

3.1.11. Nëse një pajisje është e pajisur me elemente sigurie dhe kontrolli, funksionimi i elementeve të sigurisë nuk duhet të mbizotërohet nga ai i elementeve të kontrollit.

3.1.12. Të gjitha pjesët e pajisjeve që janë vendosur ose rregulluar në fazën e prodhimit dhe të cilat nuk duhet të manipulohen nga përdoruesi ose instaluesi duhet të mbrohen në mënyrë të përshtatshme (sigurt).

3.1.13. Levat dhe elementet e tjera të kontrollit duhet të shënohen qartë dhe të kenë udhëzime adekuate në mënyrë që të parandalohet ndonjë gabim gjatë funksionimit/ përdorimit. Dizajni i tyre duhet të jetë i tillë që të përjashtojë funksionimin aksidental (të rastësishëm).

3.2. Lirimi i gazit të padjegur

3.2.1. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që niveli i rrjedhjes së gazit të mos jetë i rrezikshëm.

3.2.2. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që lirimi i gazit në çdo gjendje funksionimi (gjatë ndezjes, rindezjes apo pas fikjes së flakës) të jetë i kufizuar që të evitohet akumulimi i rrezikshëm i gazit të pa djegur në pajisje.

3.2.3. Pajisjet që synojnë të përdoren në hapësira të brendshme dhe dhoma duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që të parandalojnë lirimin e gazit të padjegur në të gjitha situatat që mund të çojnë në një akumulim të rrezikshëm të gazit të padjegur në hapësira dhe dhoma të tilla.

3.2.4. Pajisjet e dizajnuara dhe të konstruara për të djegur gaz që përmbajnë monoksid karboni ose përbërës të tjerë toksikë nuk duhet të paraqesin rrezik për shëndetin e personave dhe kafshëve shtëpiake të ekspozuara.

3.3. Ndezja

Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që, kur përdoren drejtë, ndezja dhe ri-ndezja të jetë pa pengesa dhe mesndezja të sigurohet.

3.4. Djegia

3.4.1. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që, kur përdoren drejt, procesi i djegies të jetë stabil dhe produktet e djegies të mos përmbajnë përqendrime të papranueshme të substancave të dëmshme për shëndetin.

3.4.2. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që, kur përdoren drejt, të mos ketë lirim aksidental (të rastësishëm) të produkteve të djegies.



3.4.3. Pajisjet e lidhura me një gyp për shpërndarjen e produkteve djegëse duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që në kushte anormale të mos ketë lirim (rrjedhje) të produkteve djegëse në sasi të rrezikshme në hapësirat e brendshme ose dhoma.

3.4.4. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që, kur përdoren drejt, të mos shkaktojnë përqëndrim të monoksidit të karbonit ose të substancave të tjera të dëmshme për shëndetin, të tilla si ato të cilat mund të paraqesin rrezik për shëndetin e personave dhe kafshëve shtëpiake të ekspozuara.

3.5. Përdorimi racional i energjisë

Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara dhe të konstruara në mënyrë që të sigurojnë përdorimin racional të energjisë, duke reflektuar teknologjinë moderne dhe duke marrë parasysh aspektet e sigurisë.

3.6. Temperatura

3.6.1. Pjesët e pajisjeve të cilat synohen të instalohen ose vendosen në afërsi të sipërfaqeve nuk duhet të arrijnë temperaturat që paraqesin rrezik.

3.6.2. Temperatura sipërfaqësore e pjesëve të pajisjeve të destinuara për t'u mbajtur gjatë përdorimit normal nuk duhet të paraqet rrezik për përdoruesin.

3.6.3. Temperaturat sipërfaqësore të pjesëve të jashtme të pajisjeve, me përjashtim të sipërfaqeve ose pjesëve që shoqërohen me transmetimin e nxehtësisë, në kushte të operimit nuk duhet të paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e personave të ekspozuar dhe veçanërisht për fëmijët dhe njerëzit e moshuar, për të cilët duhet të merret parasysh një kohë e përshtatshme reagimi.

3.7. Kontakti me ushqim dhe ujë të destinuar për konsum njerëzor

Pa cenuar parimet e përgjithshme të sigurisë dhe inertimit për të gjitha materialet e kontaktit me ushqim dhe rregullat për produktet e ndërtimit, materialet dhe pjesët e përdorura në konstruktimin e një pajisjeje që mund të vijnë në kontakt me ushqim ose ujë të destinuar për konsum njerëzor, siç përcaktohet në rregullat për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor, nuk duhet të dëmtojë cilësinë e ushqimit ose ujit.



SHTOJCA 2
PËRMBAJTJA E KOMUNIKIMEVE TË SHITETEVE ANËTARE TË KUSHTEVE PËR FURNIZIM ME GAZ

1. Komunikimet e dhëna në nenin 4 të kësaj Rregullore duhet të kenë përmbajtjet si në vijim:

(a)	(i) Vlerë bruto kalorifike (GCV) në MJ/m ³	minimum/maksimum;
	(ii) Wobbe indeks në MJ/m ³	minimum/maksimum.
(b)	Përbërja e gazit sipas vëllimit në % të përmbajtjes totale:	
	—përmbajtja C1 deri C5 në % (shuma)	minimum/maksimum;
	—përmbajtja N ₂ + CO ₂ në %	minimum/maksimum;
	—përmbajtja CO në %	minimum/maksimum;
	—Përmbajtja e HC e pangopur në %	minimum/maksimum;



	përbajtja e hidrogjenit në %	minimum/maksimum.
(c)		Informacion mbi përbërësit toksik të përfshirë në karburantin e gaztë.
Ky komunikim do të përfshijë një të një nga sa vijon:		
(a)	Presioni i furnizimit në hyrjen e pajisjeve në mbar:	nominal/minimum/maksimum;
(b)	(i) Presioni i furnizimit në pikën e dorëzimit në mbar:	nominal/minimum/maksimum;
	(ii) Humbje e pranueshme e presionit në instalimin e gazit të përdoruesit të fundit në mbar:	nominal/minimum/maksimum.

2. Kushtet e referencës për indeksin Wobbe dhe vlerën bruto kalorifike do të jenë si më poshtë:



(a)	Temperatura e referencës së djegies:	15 °C;
(b)	Temperatura e referencës për matjen e vëllimit:	15 °C;
(c)	Presioni i referencës për matjen e vëllimit:	1 013,25 mbar.



SHTOJCA 3

PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT PËR PAISJE DHE PJSËT LIDHËSE TË PAISJES

1. MODULI B: EKZAMINIMI I LLOJIT BE — LLOJI I PRODUKTIT

1.1. Ekzaminimi i Llojit të BE-së është pjesa e një procedure të vlerësimit të konformitetit në të cilën një trup i notifikuar ekzaminon dizajnin teknik të një pajisje ose pjesëve lidhëse të pajisjes dhe verifikon dhe ateston se dizajni teknik i pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes plotëson kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për të.

1.2. Ekzaminimi i Llojit të BE-së do të bëhet duke vlerësuar përshtatshmërinë e dizajnit teknik të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes përmes ekzaminimit të dokumentacionit teknik dhe provave mbështetëse të përmendura në pikën 1.3, plus ekzaminimin e një mostre, përfaqësues të prodhimit të parashikuar, të pajisjes komplete ose pjesëve lidhëse të pajisjes (Llojit të prodhimit).

1.3. Prodhuesi duhet të paraqesë një kërkesë për ekzaminimin e llojit të BE-së me një trup të vetëm të notifikuar sipas përzgjedhjes së tij.

1.3.1. Kërkesa përfshin si më poshtë:

(a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emri dhe adresa e tij gjithashtu;

(b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë trup tjetër të notifikuar;

(c) dokumentacionin teknik. Dokumentacioni teknik do të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore dhe do të përfshijë një analizë dhe vlerësim adekuat të rreziqeve. Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe mbulon, aq sa është e rëndësishme për vlerësimin, hartimin, prodhimin dhe funksionimin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes. Dokumentacioni teknik përmban, kur është e aplikueshme, të paktën elementet e mëposhtme:

(1) përshkrimin e përgjithshëm të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes;

(2) dizajnin konceptual dhe vizatimet e prodhuesit si dhe skemat e komponentëve, e pjesëzave, siguresave, etj .;

(3) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato vizatime dhe skema dhe funksionimin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes;



-
- (4) listën e standardeve të harmonizuara të aplikuara plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe, kur ato standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimin e alternativave të adaptuara për të përmbushur kërkesat themelore të kësaj Rregullore, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike përkatëse të përdorura. Në rast të standardeve të harmonizuara pjesërisht të aplikuara, dokumentacioni teknik duhet të specifikoj se cilat pjesë janë aplikuar;
- (5) rezultatet e llogaritjeve të bëra në dizajn, ekzaminimet e kryera, etj .;
- (6) raportet e testeve;
- (7) udhëzimet për instalimin dhe përdorimin e pajisjes;
- (8) Deklaratën e konformitetit të BE-së të pjesëve lidhëse të pajisjes që përmban udhëzimet se si duhet të inkorporohen pjesët lidhëse të pajisjes në një pajisje ose të montohen për të përbërë një pajisje;
- (d) përfaqësuesin e mostrave të prodhimit të parashikuar. Trupi i notifikuar mund të kërkojë mostra tjera, kur është e nevojshme për kryerjen e programit të testimit;
- (e) provat mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes teknike të projektimit. Kjo dëshmi mbështetëse do të përmendë çdo dokument që është përdorur, veçanërisht kur standardet përkatëse të harmonizuara nuk janë zbatuar plotësisht. Provat mbështetëse përfshijnë, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera në përputhje me specifikimet e tjera teknike përkatëse nga laboratorit përkatës i prodhuesit, ose nga një laborator tjetër testimi në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.
- 1.3.2. Kur është e përshtatshme, prodhuesi i paraqet gjithashtu trupit të notifikuar dokumentet e mëposhtme:
- (a) certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe deklaratën e konformitetit e BE në lidhje me pjesët lidhëse të pajisjes të përfshira në pajisje;
- (b) vërtetimet dhe certifikatat në lidhje me metodat e prodhimit dhe / ose inspektimit dhe / ose monitorimit të pajisjes ose pjesët lidhëse të pajisjes;



(c) çdo dokument tjetër që bën të mundur që trupi i notifikuar të përmirësojë vlerësimin e tij.

1.4. trupi i notifikuar do të:

Për pajisjen ose pjesët lidhëse të pajisjes:

1.4.1. ekzaminojë dokumentacionin teknik dhe provat mbështetëse për të vlerësuar përshtatshmërinë e dizajnit teknik të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes.

Për mostren (at):

1.4.2. verifikojë që mostra (t) janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik, dhe identifikojë elementet që janë hartuar në përputhje me dispozitat e zbatueshme të standardeve përkatëse të harmonizuara, si dhe elementet të cilat janë hartuar në përputhje me specifikimet tjera teknike përkatëse;

1.4.3. kryen ekzaminime dhe teste të përshtatshme, apo i kanë kryer ato, për të kontrolluar nëse, kur prodhuesi ka zgjedhur të aplikojë zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara, këto janë aplikuar në mënyrë korrekte;

1.4.4. kryen ekzaminime dhe teste të përshtatshme, ose i kanë kryer ato, për të kontrolluar nëse, kur zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara nuk janë aplikuar, alternativat e adaptuara nga prodhuesi duke aplikuar specifikime të tjera teknike përkatëse plotësojnë kërkesat themelore të kësaj Rregullore;

1.4.5. pajtohet me prodhuesin për një vend ku do të kryhen ekzaminimet dhe testet.

1.5. Trupi i notifikuar do të hartojë një raport vlerësimi që regjistron aktivitetet e ndërmarra në përputhje me pikën 1.4 dhe rezultatet e tyre. Pa paragjykuar detyrimet e tij përballë autoriteteve notifikuese, trupi i notifikuar lëshon përmbajtjen e këtij raporti, plotësisht ose pjesërisht, vetëm në marrëveshje me prodhuesin.

1.6. Kur lloji i pajisjes ose i pjesëve lidhëse të pajisjes i plotëson kërkesat e kësaj Rregullore, trupi i notifikuar i lëshon prodhuesit një certifikatë për ekzaminimin e llojit të BE-së. Certifikata përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, përfundimet e ekzaminimit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e tij, të dhënat e nevojshme për identifikimin e llojit të aprovuar, siç janë lloji i gazit, kategoria e pajisjes dhe presionin e furnizimit me gaz, dhe, nëse është e nevojshme, përshkrimet e punës së tij. Certifikata mund të ketë të bashkëngjitur një ose më shumë shtojca.



Certifikata për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe shtojcat e saj duhet të përmbajë të gjitha informacionet përkatëse për të mundësuar vlerësimin e konformitetit të pajisjes së prodhuar ose pjesëve lidhëse të pajisjes, me ekzaminimin e llojit dhe të mundësojë kontrollin gjatë shërbimit. Gjithashtu duhet të tregojë çdo kusht në të cilin mund t'i nënshtrohet çështja e tij dhe të shoqërohet nga përshkrimet dhe vizatimet e nevojshme për identifikimin e llojit të aprovuar.

Certifikata duhet të ketë një periudhë maksimale të vlefshmërisë dhjetë vite nga data e lëshimit të saj.

Kur lloji nuk i plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, trupi i notifikuar refuzon të lëshojë një certifikatë për ekzaminimin e llojit e BE-së për dhe do të informojë aplikantin, duke dhënë arsye të hollësishme për refuzimin e tij.

1.7. Trupi i notifikuar duhet të jetë i informuar për çdo ndryshim në raste të avancimit të teknologjisë ku mund të ketë indikacione se lloji i aprovuar nuk mund të përputhet më me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, dhe do të përcaktojë nëse këto ndryshime kërkojnë hetim të mëtejshëm. Nëse po, atëherë trupi i notifikuar duhet të informojë prodhuesit me kohë.

Prodhuesi do të informojë trupin e notifikuar që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së, për të gjitha ndryshimet në llojin e aprovuar që mund të ndikojnë në konformitetin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes me kërkesat themelore të kësaj Rregullore apo në kushtet për vlefshmëri të certifikatës. Modifikime të tilla kërkojnë miratim shtesë në formën e një shtese në certifikatën origjinale për ekzaminimin e llojit të BE-së.

1.8. Çdo trup notifikues do të informojë autoritetin e tij notifikues në lidhje me certifikatat për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe/ose çdo shtesë që e ka lëshuar ose tërhequr, dhe në mënyrë periodike ose sipas kërkesës, do të vë në dispozicion të autoritetit notifikues listën e këtyre certifikatave dhe / ose çdo shtesë në të refuzuar, pezulluar ose ndryshe kufizuar.

Çdo trup i notifikuar do të informojë trupat tjerë të notifikuar në lidhje me certifikatat për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe /ose çdo shtesë në të cilën ai ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose ndryshe kufizuar, dhe, sipas kërkesës, në lidhje me certifikatat e tilla dhe / ose shtesat të cilat i ka lëshuar.

Trupat e tjerë të notifikuar mund, me kërkesë, të marrin një kopje të certifikatave për ekzaminimin e llojit të BE-së dhe / ose shtesat e tyre. Sipas kërkesës, Komisioni dhe Shtetet Anëtare mund të marrin një kopje të dokumentacionit teknik dhe rezultatet e ekzaminimeve të kryera nga trupi i notifikuar. Trupi i notifikuar do të mbajë një kopje të certifikatës për ekzaminimin e llojit e BE-së, shtojcat dhe shtesat e tij, si dhe dosjen teknike, përfshirë dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi, deri në skadimin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.

1.9. Prodhuesi duhet të mbajë një kopje të certifikatës të ekzaminimit të llojit të BE-së, shtojcat dhe shtesat e tij së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve për mbikqyrje të tregut për 10 vite pasi të jetë vendosur në treg pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes.

1.10. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqesë kërkesën e përmendur në pikën 1.3 dhe të përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikat 1.7 dhe 1.9, me kusht që ato të specifikohen në autorizimin me shkrim.



2. MODULI C2: KONFORMITETI ME LLOJIN E BAZUAR NË KONTROLLIN E BRENDSHËM TË PRODHIMIT DHE KONTROLLEVE TE MBIKQYRURA TË PRODUKTEVE SIPAS RASTIT

2.1. Konformiteti me llojin e bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit dhe kontrollimeve të mbikëqyrura të produkteve sipas rastit është pjesë e një procedure të vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2.2, 2.3 dhe 2.4, dhe siguron dhe deklaron në përgjegjësinë e tij të vetme që pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjes në fjalë janë konform me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe përmbushin kërkesat e kësaj Rregullore që vlejné për to.

2.2. Prodhimi

Prodhuesi do të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes të prodhuara me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe me kërkesat e kësaj Rregullore që vlejné për to.

2.3. Kontrollat e produkteve

Trupi i notifikuar, i zgjedhur nga prodhuesi, do të kryejë kontrole të produktit ose t'i ketë kryer ato në intervalet prej një viti ose më pak, në mënyrë që të verifikojë cilësinë e kontrolleve të brendshme në pajisje ose pjesë lidhëse të pajisjes duke marrë parasysh, ndër të tjera, kompleksitetin teknologjik të pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes dhe sasinë e prodhimit. Një mostër adekuate e pajisjeve finale ose pjesëve lidhëse të pajisjes të mbledhura në vend nga trupi i notifikuar para vendosjes në treg, do të ekzaminohet dhe testet e duhura, të përcaktuara nga pjesët përkatëse të standardeve të harmonizuara, dhe / ose testet ekuivalente të përcaktuara në të tjera specifikuimet teknike relevante, do të kryhen për të kontrolluar konformitetin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes me kërkesat përkatëse të kësaj Rregullore. Kur një mostër nuk është konform me nivelin e pranueshëm të cilësisë, trupi i notifikuar do të merr masat e duhura.

Procedura e marrjes së mostrave që do të aplikohet ka për qëllim të përcaktojë nëse procesi i prodhimit të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes kryhen brenda kufijve të pranueshëm, me qëllim të sigurimit të konformitetit të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes.

Prodhuesi, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar, do të vendos numrin e identifikimit të trupit të notifikuar gjatë procesit të prodhimit.

2.4. Shënjimi CE dhe deklarata e konformitetit të BE-së

2.4.1. Prodhuesi do të vendosë shenjën CE në secilën pajisje individuale ose pjesët lidhëse të pajisjes që është në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.



2.4.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit e BE-së për secilën pajisje ose pjesë lidhëse të pajisjes dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut për 10 vite pasi që pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes të jenë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së do të identifikojë modelin e pajisjes ose pjesës lidhëse të pajisjes për të cilin është hartuar. Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së do të vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse, me kërkesë. Një kopje e deklaratës konformitetin e BE-së për pjesët lidhëse të pajisjes duhet t'i shoqërojë pjesët lidhëse të pajisjes ose, kur është e përshtatshme, llotin ose dërgesën.

2.5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 2.4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të përcaktohen në autorizimin me shkrim.

3. MODULI D: KONFORMITETI ME LLOJIN E BAZUAR NË SIGURINË E CILËSISË TË PROCESIT TË PRODHIMIT

3.1. Konformiteti me llojin e bazuar në sigurinë e cilësisë të procesit të prodhimit është pjesa e një procedure të vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 3.2 dhe 3.5, dhe siguron dhe deklaron në përgjegjësinë e tij të vetme që pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjes në fjalë janë konform me llojin e përshkruar në certifikatat për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore që vlejné për to.

3.2. Prodhuesi

Prodhuesi do të përdorë një sistem të aprovuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin e produktit të fundit dhe testimin e pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes siç përcaktohet në pikën 3.3, dhe do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes siç përcaktohet në pikën 3.4.

3.3. Sistemi i cilësisë

3.3.1. Prodhuesi do të parashtojë kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë pranë trupit të notifikuar sipas përzgjedhjes së tij, për pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjeve në fjalë.

Kërkesa do të përfshijë:

- (a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa parashtrohet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e tij gjith hashtu;
- (b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur pranë ndonjë trupi tjetër të notifikuar;
- (c) të gjithë informacionin përkatës për pajisjen ose pjesët lidhëse të pajisjeve të aprovuara në modulin B;
- (d) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;
- (e) dokumentacionin teknik të llojit të aprovuar dhe një kopje të certifikatës për ekzaminimin e llojit e BE.



3.3.2. Sistemi i cilësisë siguron që pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjeve janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe përputhen me kërkesat e kësaj Rregullore që vlejnë për to.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi do të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë lejon një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave të cilësisë.

Në veçanti, duhet të përmbajë një përshkrim adekuat të:

- (a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësi dhe kompetencave të menaxhimit në lidhje me cilësinë e produktit;
- (b) prodhimit korrespondues, teknikave të kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike që do të përdoren;
- (c) ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, dhe frekuencën me të cilën do të kryhen;
- (d) regjistrimeve të cilësisë, siç janë raportet e inspektimit dhe të dhënat e provës, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit për personelin në fjalë, etj;
- (e) mjeteve të monitorimit të arritjes së cilësisë së produktit të kërkuar dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3.3. Trupi i notifikuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3.3.2.

Ai do të prezumojë konformitetin me ato kërkesa në lidhje me elementët e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet përkatëse të standardit përkatës të harmonizuar.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit do të ketë së paku një anëtar me përvojë vlerësimi në fushën përkatëse të produktit dhe teknologjinë e produktit në fjalë, dhe njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit. Ekipi i auditimit do të rishikojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 3.3.1 (e), për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të kësaj Rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes me ato kërkesa.

Vendimi do t'i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.3.4. Prodhuesi do të marrë përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë siç është aprovuar dhe ta ruajë atë në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.



3.3.5. Prodhuesi duhet ta mbajë të njoftuar trupin e notifikuar që ka aprovuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i notifikuar do të vlerësojë çdo ndryshim të propozuar dhe vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.3.2 ose nëse një rivlerësim është i nevojshëm.

Do të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar

3.4.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është të sigurohet që prodhuesi i përmbushë rregullisht detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

3.4.2. Prodhuesi, për qëllime vlerësimi, do t'i lejojë trupit të notifikuar qasje në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit dhe ruajtjes dhe do të ia sigurojë atij të gjitha informacionet e nevojshme, veçanërisht:

(a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

(b) regjistrimet e cilësisë, siç janë raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit për personelin në fjalë, etj.

3.4.3. Trupi i notifikuar do të kryejë kontrole periodike të paktën çdo dy vite për të siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe do t'i sigurojë prodhuesit një raport të auditimit.

3.4.4. Për më tepër, trupi i notifikuar mund të bëjë vizita të papritura te prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla, trupi i notifikuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste të produktit, ose t'i ketë kryer ato, me qëllim që të verifikojë që sistemi i cilësisë po funksionon në mënyrë korrekte. Trupi i notifikuar do t'i sigurojë prodhuesit një raport të vizitës dhe, nëse janë bërë teste, gjithashtu do t'i sigurojë edhe raportin e testimit.

3.5. Shënjimi i CE dhe deklarata e konformitetit e BE-së

3.5.1. Prodhuesi do të vendos shenjën CE dhe, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar të përmendur në pikën 3.3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit për secilën pajisje individuale ose pjesë lidhëse të pajisjes që është në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

3.5.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE-së për secilën pajisje ose pjesë lidhëse të pajisjes dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut për 10 vite pas vendosjes së pajisjes apo pjesëve lidhëse të pajisjes në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së do të identifikojë modelin e pajisjes ose pjesës lidhëse të pajisjes për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse, sipas kërkesës. Një kopje e deklaratës së BE-së për konformitetin e pjesëve lidhëse të pajisjes duhet të shoqërojë pjesët lidhëse të pajisjes, kur është e përshtatshme, llotin ose dërgesën.



3.6. Prodhuesi, për një periudhë së paku 10 vjeçare pasi që pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes të jenë vendosur në treg, do ta mbajë në dispozicion të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dokumentet si në vijim:

(a) dokumentacionin e përmendur në pikën 3.3.1;

(b) informacionin në lidhje me ndryshimin e përmendur në pikën 3.3.5, të aprovuar;

(c) vendimet dhe raportet e trupit të notifikuar të përmendur në pikat 3.3.5, 3.4.3 dhe 3.4.4.

3.7. Çdo trup i notifikuar do të informojë autoritetin e tij notifikues për miratimet e sistemit të cilësisë, të lëshuara ose të tërhequra, dhe, në mënyrë periodike ose me kërkesë, do t'i vë në dispozicion autoritetit notifikues listën e miratimeve të sistemeve të cilësisë, të refuzuara, të pezulluara ose ndryshe të kufizuara.

Çdo trup notifikues do të informojë trupat e tjerë të notifikuar për miratimet e sistemit të cilësisë, të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr ose ndryshe kufizuar, dhe, sipas kërkesës, për miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

3.8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.3.1, 3.3.5, 3.5 dhe 3.6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të specifikohen në autorizim me shkrim.

4. MODULI E: KONFORMITETI ME LLOJIN E BAZUAR NË SIGURINË E CILËSISË TË PRODUKTIT

4.1. Konformiteti me llojin bazuar në sigurinë e cilësisë së produktit është ajo pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 4.2 dhe 4.5, dhe siguron dhe deklaron në përgjegjësinë e tij të vetme që pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjes janë në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore që aplikohen për to.

4.2. Prodhimi

Prodhuesi do të përdorë një sistem të aprovuar të cilësisë për inspektimin dhe testimin e produktit përfundimtar të pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes siç përcaktohet në pikën 4.3 dhe do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes siç përcaktohet në pikën 4.4.

4.3. Sistemi i cilësisë

4.3.1. Prodhuesi do të parashtrojë kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë pranë trupit të notifikuar sipas përzgjedhjes së tij, për pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjeve në fjalë.

Kërkesa do të përfshijë:

(a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa parashtrohet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e tij gjithashtu;



- (b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur pranë ndonjë trupi tjetër të notifikuar;
- (c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e produktit të parashikuar;
- (d) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë; dhe
- (e) dokumentacionin teknik të llojit të aprovuar dhe një kopje të certifikatës për ekzaminimin e llojit e BE.

4.3.2. Sistemi i cilësisë siguron që pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjeve janë në përputhshmëri me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe me kërkesat e kësaj Rregullore.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi do të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë lejon një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave të cilësisë.

Në veçanti, duhet të përmbajë një përshkrim adekuat të:

- (a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësi dhe kompetencave të menaxhimit në lidhje me cilësinë e produktit;
- (b) ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen pas prodhimit;
- (c) regjistrimeve të cilësisë, siç janë raportet e inspektimit dhe të dhënat e provës, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit për personelin në fjalë, etj;
- (d) mjetet e monitorimit të funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

4.3.3. Trupi i notifikuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 4.3.2.

Ai do të prezumojë konformitetin me ato kërkesa në lidhje me elementët e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet përkatëse të standardit përkatës të harmonizuar.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit do të ketë së paku një anëtar me përvojë vlerësimi në fushën përkatëse të produktit dhe teknologjinë e produktit në fjalë, dhe njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit. Ekipi i auditimit do të rishikojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 4.3.1 (e), për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të kësaj Rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes me ato kërkesa.



Vendimi do t'i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4.3.4. Prodhuesi do të marrë përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë siç është aprovuar dhe ta ruajë atë në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.

4.3.5. Prodhuesi duhet ta mbajë të njoftuar trupin e notifikuar që ka aprovuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i notifikuar do të vlerësojë çdo ndryshim të propozuar dhe vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 4.3.2 ose nëse një rivlerësim është i nevojshëm.

Do të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4.4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar

4.4.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është të sigurohet që prodhuesi i përmbushë rregullisht detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

4.4.2. Prodhuesi, për qëllime vlerësimi, do t'i lejojë trupit të notifikuar qasje në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit dhe ruajtjes dhe do të ia sigurojë atij të gjitha informacionet e nevojshme, veçanërisht:

(a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

(b) regjistrimet e cilësisë, siç janë raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit për personelin në fjalë, etj.

4.4.3. Trupi i notifikuar do të kryejë kontrole periodike të paktën çdo dy vite për të siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe do t'i sigurojë prodhuesit një raport të auditimit.

4.4.4. Për më tepër, trupi i notifikuar mund të bëjë vizita të papritura te prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla, trupi i notifikuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste të produktit, ose t'i ketë kryer ato, me qëllim që të verifikojë që sistemi i cilësisë po funksionon në mënyrë korrekte. Trupi i notifikuar do t'i sigurojë prodhuesit një raport të vizitës dhe, nëse janë bërë teste, gjithashtu do t'i sigurojë edhe raportin e testimit.

4.5. Shënjimi i CE dhe deklarata e konformitetit e BE-së

4.5.1. Prodhuesi do të vendos shenjën CE dhe, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar të përmendur në pikën 4.3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit për secilën pajisje individuale ose pjesë lidhëse të pajisjes që është në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit BE-së dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

4.5.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE për secilin model të pajisjes ose pjesës lidhëse të pajisjes dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut për 10 vite pas vendosjes së pajisjes apo pjesëve lidhëse të



pajisjes në treg. Deklarata e konformitetit të BE-së do të identifikojë modelin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse, sipas kërkesës. Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së e pjesëve lidhëse të pajisjes duhet të shoqërojë pjesët lidhëse të pajisjes, kur është e përshtatshme, llotin ose dërgesën.

4.6. Prodhuesi, për një periudhë së paku 10 vjeçare pasi që pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes të jenë vendosur në treg, do ta mbajë në dispozicion të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut:

(a) dokumentacionin e përmendur në pikën 4.3.1;

(b) informacionin në lidhje me ndryshimin e përmendur në pikën 4.3.5, të aprovuar;

(c) vendimet dhe raportet e trupit të notifikuar të përmendur në pikat 4.3.5, 4.4.3 dhe 4.4.4.

4.7. Çdo trup i notifikuar do të informojë autoritetin e tij notifikues për miratimet e sistemit të cilësisë, të lëshuara ose të tërhequra, dhe, në mënyrë periodike ose me kërkesë, do t'i vë në dispozicion autoritetit notifikues listën e miratimeve të sistemeve të cilësisë, të refuzuara, të pezulluara ose ndryshe të kufizuara.

Çdo trup notifikues do të informojë trupat e tjerë të notifikuar për miratimet e sistemit të cilësisë, të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr ose ndryshe kufizuar, dhe, sipas kërkesës, për miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

4.8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 4.3.1, 4.3.5, 4.5 dhe 4.6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të specifikohen në autorizimin me shkrim.

5. MODULE F: KONFORMITETI ME LLOJIN E BAZUAR NË VERIFIKIMIN E PRODUKTIT

5.1. Konformiteti me llojin bazuar në verifikimin e produktit është ajo pjesë e procedurës të vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 5.2, 5.5.1 dhe 5.6 dhe siguron dhe deklaron në përgjegjësinë e tij të vetme që pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjes të cilat i janë nënshtruar pikës 5.3, janë në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit të BE-së dhe plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore që aplikohen për to.

5.2. Prodhimi

Prodhuesi do të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë konformitetin e pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes me llojin e aprovuar të përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit të BE-së dhe me kërkesat e kësaj Rregullore që vlejné për to.



5.3. Verifikimi

Trupi i notifikuar i zgjedhur nga prodhuesi duhet të kryejë ekzaminime dhe teste të përshtatshme, ose t'i ketë kryer ato, për të kontrolluar përputhshmërinë e pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes me llojin e aprovuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit të BE-së dhe me kërkesat relevante të kësaj Rregullore.

Ekzaminimet dhe testet për të kontrolluar konformitetin e pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes me kërkesat relevante duhet të kryhen, sipas zgjedhjes së prodhuesit, ose me ekzaminimin dhe testimin e çdo pajisje ose pjesëve lidhëse të pajisjes siç përcaktohet në pikën 5.4 ose me ekzaminimin dhe testimin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes mbi baza statistikore siç përcaktohet në pikën 5.5.

5.4. Verifikimi i konformitetit me anë të ekzaminimit dhe testimit të çdo pajisjeje ose pjesëve lidhëse të pajisjes

Të gjitha pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjes duhet të ekzaminohen individualisht dhe duhet të bëhen testet e duhura të përcaktuara në standardin/et e harmonizuar dhe / ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike përkatëse për të verifikuar konformitetin me llojin e aprovuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit të BE-së për dhe me kërkesat relevante të kësaj Rregullore.

Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, trupi i notifikuar në fjalë vendos për testet relevante që do të kryhen.

5.4.2. Trupi i notifikuar lëshon certifikatën e konformiteti për sa i përket ekzaminimeve dhe testeve të kryera, dhe do t'ia vendos numrin e tij të identifikimit secilës pajisje të aprovuar ose pjesë lidhëse të pajisjes, ose e ka vendosur atë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi duhet të mbajë në dispozicion certifikatat e konformitetit për inspektim nga autoritetet për mbikqyrje të tregut për 10 vite pasi pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes të jenë vendosur në treg.

5.5. Verifikimi statistikor i konformitetit

5.5.1. Prodhuesi do të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë homogjenitetin e secilit lot të prodhuar, dhe të paraqesë pajisjet e tij ose pjesët lidhëse të pajisjes për verifikim në formën e pjesëve homogjene.

5.5.2. Një mostër e rastit merret nga secili lot në përputhje me kërkesat e pikës 5.5.3. Të gjitha pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjes në një mostër do të ekzaminohen individualisht dhe testet e relevante të përcaktuara në standardet përkatëse të harmonizuara dhe / ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike përkatëse, do të kryhen për të verifikuar konformitetin e tyre me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore dhe për të përcaktuar nëse lloti pranohet ose refuzohet. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, trupi i notifikuar në fjalë vendos për testet relevante që do të kryhen.

5.5.3. Trupi i notifikuar do të aplikojë një sistem të marrjes së mostrave me karakteristikat e mëposhtme:

— Nivelin e cilësisë që korrespondon me mundësi të pranimit prej 95%, me një përqindje jo konformiteti mes 0,5% dhe 1,5%,

— Kualitetin e cilësisë kufi që korrespondon me mundësi të pranimit prej 5% me një përqindje jo konformiteti midis 5% dhe 10%.



5.5.4. Nëse pranohet loti, të gjitha pajisjet ose pjesët lidhëse të pajisjes së lotit do të konsiderohen të aprovuara, përveç atyre pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes nga mostra e testuar që janë konstatuar se nuk i plotësojnë kërkesat.

Trupi i notifikuar do të lëshojë një certifikatë të konformitetit për sa i përket ekzaminimeve dhe testeve të kryera, dhe do të ia vendos numrin e tij të identifikimit secilës pajisje ose pjesë lidhëse të pajisjes të aprovuar, apo e ka vendosur atë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi duhet të mbajë në dispozicion të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut certifikatat e konformitetit për 10 vite pasi që pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes të jenë vendosur në treg.

5.5.5. Nëse refuzohet loti, trupi i notifikuar ose autoriteti kompetent do të marrë masat e duhura për të parandaluar vendosjen e lotit në treg. Në rast të refuzimit të shpeshtë të loteve, trupi i notifikuar mund të pezullojë verifikimin statistikor dhe të marrë masat e duhura.

5.6. Shënjimi i CE dhe deklarata e konformitetit e BE-së

5.6.1. Prodhuesi do të vendos shenjën CE dhe, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar të përmendur në pikën 5.3, numrin e identifikimit të këtij të fundit për secilën pajisje individuale ose pjesë lidhëse të pajisjes që është në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e llojit e BE-së dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

5.6.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE për secilin model të pajisjes ose pjesë lidhëse të pajisjes dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut për 10 vite pas vendosjes së pajisjes apo pjesëve lidhëse të pajisjes në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së do të identifikojë modelin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse, sipas kërkesës. Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së e pjesëve lidhëse të pajisjes duhet të shoqërojë pjesët lidhëse të pajisjes, kur është e përshtatshme, llotin ose dërgesën.

Nëse trupi i notifikuar i përmendur në pikën 5.3 pajtohet dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë numrin e identifikimit të trupit të notifikuar në pajisje ose në pjesë lidhëse të pajisjes.

5.7. Nëse trupi i notifikuar pajtohet dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë numrin e identifikimit të trupit të notifikuar në pajisje ose pjesë lidhëse të pajisjes gjatë procesit të prodhimit.

5.8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të përcaktohen në autorizimin me shkrim. Një përfaqësues i autorizuar nuk mund të përmbushë detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 5.2 dhe 5.5.1.



6. MODULI G: KONFORMITETI I BAZUAR NË VERIFIKIMIN E NJËSISË

6.1. Konformiteti i bazuar në verifikimin e njësisë është procedura e vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 6.2, 6.3 dhe 6.5, dhe siguron dhe deklaron në përgjegjësinë e tij të vetme që pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes në fjalë, i cili i është nënshtuar pikës 6.4, është në konformitet me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për të.

6.2. Dokumentacioni Teknik

Prodhuesi do ta krijojë dokumentacionin teknik dhe do të ia vë në dispozicion trupit të notifikuar të përmendur në pikën 6.4. Dokumentacioni teknik do të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, dhe do të përfshijë analizën dhe vlerësimin adekuat të rreziqeve. Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e zbatueshme dhe mbulon, aq sa është e rëndësishme për vlerësimin, dizajnimin, konstruktimit dhe funksionimin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes.

6.2.1. Dokumentacioni teknik, kur është e mundur, do të përmbajë të paktën elementët e mëposhtme:

- (a) një përshkrim të përgjithshëm të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes;
- (b) dizajnet konceptuale dhe vizatimet dhe skemat e konstruktimit të komponentëve, pjesëzat, qarqet, etj .;
- (c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato vizatime dhe skema dhe funksionimin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes;
- (d) një listë të standardeve të harmonizuara të aplikuara plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, dhe, kur ato standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për të përmbushur kërkesat themelore të kësaj Rregullore, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike përkatëse të përdorura. Në rast të standardeve të harmonizuara pjesërisht të aplikuara, dokumentacioni teknik përcakton pjesët që janë aplikuar;
- (e) rezultatet e llogaritjeve të bëra në dizajn, ekzaminimet e kryera, etj .;
- (f) raportet e provave;
- (g) udhëzime për instalim dhe përdorim, për pajisje;
- (h) udhëzimet për inkorporim në një pajisje ose për pjesë lidhëse të pajisjes.

6.2.2. Kur është e përshtatshme, prodhuesi i paraqet gjithashtu trupit të notifikuar dokumentet e mëposhtme:



- (a) certifikata për ekzaminim e llojit e BE-së dhe deklaratën e konformitetit e BE në lidhje me pjesë lidhëse të pajisjes të përfshira në pajisje
- (b) vërtetimet dhe certifikatat në lidhje me metodat e konstruktimit, inspektimit dhe monitorimit të pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes.
- (c) çdo dokument tjetër që bën të mundur që trupi i notifikuar të përmirësojë vlerësimin e tij.
Prodhuesi do të mbajë në dispozicion të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut dokumentacionin teknik për 10 vite pasi që pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes të jenë vendosur në treg.

6.3. Prodhimi

Prodhuesi do të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjeve të prodhuara me kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje.

6.4. Verifikimi

Trupi i notifikuar i zgjedhur nga prodhuesi duhet të kryejë ekzaminime dhe teste të përshtatshme, të përcaktuara në standardet përkatëse të harmonizuara dhe / ose teste ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike përkatëse, për të kontrolluar konformitetin e pajisjeve ose pjesëve lidhëse të pajisjes me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, ose nëse i kanë realizuar ato. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar trupi i notifikuar në fjalë do të vendosë për testet e duhura që do të kryhen.

Nëse konsiderohet e nevojshme nga trupi i notifikuar, ekzaminimet dhe testet mund të kryhet pas inkorporimit të përshtatshëm, montimit ose instalimit të pajisjes.

Trupi i notifikuar do të lëshojë një certifikatë konformiteti për sa i përket ekzaminimeve dhe testeve të kryera dhe do t'ia vendos numrin e tij të identifikimit pajisjeve të aprovuara ose pjesëve lidhëse të pajisjes, ose e vendos atë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi duhet të mbajë në dispozicion të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut certifikatat e konformitetit për 10 vjet pasi pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes të jenë vendosur në treg.

6.5. Shënjimi CE dhe deklarata e konformitetit e BE-së

6.5.1. Prodhuesi do të vendos shenjën CE dhe, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar të përmendur në pikën 6.4, numrin identifikimit të këtij të fundit për secilën pajisje ose pjesë lidhëse të pajisjes që plotësojnë kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.



6.5.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut për 10 vite pasi pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes të jenë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së do të identifikojë pajisjen ose pjesët lidhëse të pajisjes për të cilat është hartuar.

Pas kërkesës, një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse. Një kopje e deklaratës të konformitetit e BE-së e pjesëve lidhëse të pajisjes duhet të shoqërojë pjesët lidhëse të pajisjes ose, kur është e përshtatshme, grupin ose dërgesën.

6.6. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 6.2 dhe 6.5 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të specifikohen në autorizimin me shkrim.



SHTOJCA 4

MBISHKRIMET

1. Përveç shënjimit CE të përmendur në nenin 16, pajisja ose pllaka e saj e të dhënave duhet të ketë informacionin e mëposhtëm:
 - (a) emrin e prodhuesit, emrin tregtar të regjistruar ose markën tregtare të regjistruar;
 - (b) llojin e pajisjes, serinë ose numrin serik të pajisjes ose elementit tjetër që lejon identifikimin e saj;
 - (c) llojin e furnizimit elektrik të përdorur, kur është e aplikueshme;
 - (d) shënjimin e kategorisë së pajisjes;
 - (e) presionin nominal të furnizimit për pajisjen;
 - (f) informacionin e nevojshëm për të siguruar instalimin e saktë dhe të sigurt, sipas natyrës së pajisjes.
2. Pjesët lidhëse të pajisjes ose pllaka e tyre duhet të ketë, aq sa është relevante, informacionin e parashikuar në pikën 1.



SHTOJCA 5
DEKLARATA E KONFORMITETIT E BE Nr ... (1)

1. Pajisja ose pjesët lidhëse të pajisjes / modeli i pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes (produkti, lloji, seria ose numri serik):
2. Emri dhe adresa e prodhuesit dhe, kur aplikohet, përfaqësuesi i tij i autorizuar
3. Kjo deklaratë e konformitetit lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit.
4. Objekti i deklaratës (identifikimi i pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes që lejon gjurmueshmërinë; kur është e nevojshme për identifikimin e pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes, mund të përfshihet një imazh): përshkrimi i pajisjes ose pjesëve lidhëse të pajisjes.
5. Objekti i deklaratës së përshkruar në pikën 4 është në përputhje me legjislacionin përkatës:... (referencë për aktet e tjera të aplikuara).
6. Referencat për standardet përkatëse të harmonizuara të përdorura ose referencat në specifikimet e tjera teknike në lidhje me të cilat deklarohet konformiteti:
7. Trupi i caktuar / notifikuar... (emri, adresa, numri)... ka kryer... (përshkrimin e ndërhyrjes)... dhe ka lëshuar certifikatën/at:... (detajet, përfshirë datën, dhe, kur është e përshtatshme, informacion për kohëzgjatjen dhe kushtet e vlefshmërisë të saj).
8. Në rastin e pjesëve lidhëse të pajisjes, udhëzimet se si duhet të përfshihen në një pajisje ose të montohen pjesët lidhëse të pajisjes për të krijuar një pajisje në mënyrë që të ndihmojë përputhshmërinë me kërkesat themelore të zbatueshme për pajisjet e përfunduara.
9. Informata shtesë:
Nënshkruar në emër të: ...
(vendi dhe data e lëshimit):



(emri, funksioni) (nënshkrimi):

(1) Është opsionale për prodhuesin të caktojë një numër në deklaratën e konformitetit.



ANNEX 1

ESSENTIAL REQUIREMENTS

PRELIMINARY OBSERVATIONS:

1. The essential requirements laid down in this Regulation are compulsory.
2. The essential requirements are to be interpreted and applied in such a way as to take into account the state of the art, technological advances and current practice at the time of design and manufacture as well as technical and economic considerations which are consistent with a high degree of energy efficiency and of health and safety protection.

1. GENERAL REQUIREMENTS

1.1. Appliances shall be so designed and constructed as to operate safely and present no danger to persons, domestic animals or property, when normally used.

Fittings shall be so designed and constructed as to fulfil correctly their intended purpose when incorporated into an appliance or assembled to constitute an appliance.

1.2. The manufacturer is under an obligation to analyse the risks in order to identify those which apply to his appliance or fitting. He shall then design and construct it taking into account its risk assessment.

1.3. In selecting the most appropriate solutions, the manufacturer shall apply the principles set out below, in the following order:

- (a) eliminate or reduce risks as far as possible (inherently safe design and construction);
- (b) take the necessary protection measures in relation to risks that cannot be eliminated;
- (c) inform users of the residual risks due to any shortcomings of the protection measures adopted and indicate whether any particular precautions are required.



1.4. When designing and constructing the appliance, and when drafting the instructions, the manufacturer shall envisage not only the intended use of the appliance, but also the reasonably foreseeable uses.

1.5. All appliances shall:

- (a) be accompanied by instructions for installation intended for the installer;
- (b) be accompanied by instructions for use and servicing, intended for the user;
- (c) bear appropriate warning notices, which shall also appear on the packaging.

1.6.1. The instructions for installation intended for the installer shall contain all the instructions for installation, adjustment and servicing required to ensure that those operations are correctly performed so that the appliance may be used safely.

The instructions for installation intended for the installer shall include also information on the technical specifications of the interface between the appliance and its installation environment allowing its correct connection to the gas supply network, the supply of auxiliary energy, the combustion air supply and the flue gas evacuation system.

1.6.2. The instructions for use and servicing intended for the user shall contain all the information required for safe use and in particular shall draw the user's attention to any restrictions on use.

The manufacturers shall note in the instructions where additional care is needed or where it would be advisable that any of the above work be carried out by a professional. This shall be without prejudice to national requirements to that effect.

The manufacturer of the appliance shall include in the instructions accompanying the appliance all necessary information for adjustment, operation and maintenance of the fittings as part of the finished appliance, as appropriate.

1.6.3. The warning notices on the appliance and its packaging shall clearly state the type of gas to be used, the gas supply pressure, the appliance category and any restrictions on use, in particular the restriction whereby the appliance shall be installed only in areas where there is sufficient ventilation so as to ensure that the risks presented by it are minimised.

1.7. The instructions for incorporation of the fitting into an appliance or its assembly in order to constitute an appliance and for its adjustment, operation and maintenance shall be provided with the fittings concerned as part of the EU declaration of conformity.



2. MATERIALS

Materials for appliances or fittings shall be appropriate for their intended purpose and shall withstand the mechanical, chemical and thermal conditions to which they will foreseeably be subjected.

3. DESIGN AND CONSTRUCTION

The obligations arising for appliances from the essential requirements set out in this point apply also to fittings, as far as relevant.

3.1. General

3.1.1. Appliances shall be so designed and constructed that, when normally used, no instability, distortion, breakage or wear likely to impair their safety may occur.

3.1.2. Condensation produced at the start-up and/or during use shall not affect the safety of appliances.

3.1.3. Appliances shall be so designed and constructed as to minimise the risk of explosion in the event of a fire of external origin.

3.1.4. Appliances shall be so designed and constructed that water and inappropriate air penetration into the gas circuit does not occur.

3.1.5. In the event of a normal fluctuation of auxiliary energy, appliances shall continue to operate safely.

3.1.6. Abnormal fluctuation or failure of auxiliary energy or its restoration shall not lead to an unsafe situation.

3.1.7. Appliances shall be so designed and constructed as to obviate any gas-related risks due to hazards of electrical origin. As far as relevant, the results of the conformity assessment in relation to the safety requirements of the rules on radio equipment or the safety objectives of the rules on low voltage equipment shall be taken into account.

3.1.8. Appliances shall be so designed and constructed as to obviate any gas-related risks due to hazards originating from electromagnetic phenomena. As far as relevant, the results of the conformity assessment in relation to the electromagnetic compatibility requirements of the rules on radio equipment or the rules on electromagnetic compatibility shall be taken into account.

3.1.9. All pressurised parts of an appliance shall withstand the mechanical and thermal stresses to which they are subjected without any deformation affecting safety. All parts of the appliance subjected to pressure must withstand mechanical and thermal loads without suffering any deformation that may affect safety.



3.1.10. Appliances shall be so designed and constructed that failure of a safety, controlling or regulating device may not lead to an unsafe situation.

Appliances must be designed and constructed in such a way that damage to a safety device, control or adjustment, cannot cause any dangerous situation.

3.1.11. If an appliance is equipped with safety and controlling devices, the functioning of the safety devices shall not be overruled by that of the controlling elements.

3.1.12. All parts of appliances which are set or adjusted at the stage of manufacture and which should not be manipulated by the user or the installer shall be appropriately protected (safely).

3.1.13. Levers and other controlling and setting devices shall be clearly marked and give appropriate instructions so as to prevent any error in operation/use. Their design shall be such as to preclude accidental operation.

3.2. Unburned gas release

3.2.1. Appliances shall be so designed and constructed that the gas leakage rate is not dangerous.

3.2.2. Appliances shall be so designed and constructed that gas release at any state of operation (during ignition, re-ignition or after flame extinction) is limited in order to avoid a dangerous accumulation of unburned gas in the appliance.

3.2.3. Appliances intended to be used in indoor spaces and rooms shall be so designed and constructed as to prevent the release of unburned gas in all situations which could lead to a dangerous accumulation of unburned gas in such spaces and rooms.

3.2.4. Appliances designed and constructed to burn gas containing carbon monoxide or other toxic components shall not present a danger to the health of persons and domestic animals exposed.

3.3. Ignition

Appliances shall be so designed and constructed that, when normally used, ignition and re-ignition is smooth and cross-lighting is assured.

3.4. Combustion



3.4.1. Appliances shall be so designed and constructed that, when normally used, the combustion process is stable and combustion products do not contain unacceptable concentrations of substances harmful to health.

3.4.2. Appliances shall be so designed and constructed that, when normally used, there will be no accidental release of combustion products.

3.4.3. Appliances connected to a flue for the dispersal of combustion products shall be so designed and constructed that in abnormal draught conditions there is no release of combustion products in a dangerous quantity into the indoor spaces or rooms concerned.

3.4.4. Appliances shall be so designed and constructed that, when normally used, they do not cause a concentration of carbon monoxide or other substances harmful to health, such as they would be likely to present a danger to the health of persons and domestic animals exposed.

3.5. Rational use of energy

Appliances shall be so designed and constructed as to ensure rational use of energy, reflecting the modern technology and taking into account safety aspects.

3.6. Temperature

3.6.1. Parts of appliances which are intended to be installed or placed in close proximity to surfaces shall not reach temperatures which present a danger.

3.6.2. The surface temperature of parts of appliances intended to be handled during normal use shall not present a danger to the user.

3.6.3. The surface temperatures of external parts of appliances, with the exception of surfaces or parts which are associated with the transmission of heat, shall not under operating conditions present a danger to the health and safety of persons exposed and in particular to children and elderly people, for whom an appropriate reaction time shall be taken into account.

3.7. Contact with food and water intended for human consumption

Without prejudice to the general principles of safety and inertness for all Food Contact Materials and the rules on construction products, materials and parts used in the construction of an appliance which may come into contact with food or water intended for human consumption as defined in the rules on the quality of water intended for human consumption, shall not impair quality of the food or water.



ANNEX 2

CONTENT OF THE MEMBER STATES COMMUNICATIONS OF THE GAS SUPPLY CONDITIONS

1. The communications provided for in Article 4 of this Regulation shall have the following content:

(a)	(i) Gross calorific value (GCV) in MJ/m ³	minimum/maximum;
	(ii) Wobbe index in MJ/m ³	minimum/maximum.
(b)	Gas composition by volume in % of the total content:	
	—C ₁ to C ₅ content in % (sum)	minimum/maximum;
	—N ₂ + CO ₂ content in %	minimum/maximum;
	—CO content in %	minimum/maximum;
	—unsaturated HC content in %	minimum/maximum;



	—hydrogen content in %	minimum/maximum.
(c)	Information on toxic components contained in the gaseous fuel.	
That communication shall also include either of the following:		
(a)	Supply pressure at the inlet of appliances in mbar:	nominal/minimum/maximum;
(b)	(i) Supply pressure at the point of delivery in mbar:	nominal/minimum/maximum;
	(ii) Admissible pressure loss in the end-user gas installation in mbar:	nominal/minimum/maximum.



2. The reference conditions for Wobbe index and gross calorific value shall be the following:

(a)	Combustion reference temperature:	15 °C;
(b)	Volume measurement reference temperature:	15 °C;
(c)	Volume measurement reference pressure:	1 013,25 mbar.



ANNEX 3

CONFORMITY ASSESSMENT PROCEDURES FOR APPLIANCES AND FITTINGS

1. MODULE B: EU TYPE-EXAMINATION — PRODUCTION TYPE

1.1. EU type-examination is the part of a conformity assessment procedure in which a notified body examines the technical design of an appliance or a fitting and verifies and attests that the technical design of the appliance or the fitting meets the requirements of this Regulation that apply to it.

1.2. EU type-examination shall be carried out by assessment of the adequacy of the technical design of the appliance or the fitting through examination of the technical documentation and supporting evidence referred to in point 1.3, plus examination of a specimen, representative of the production envisaged, of the complete appliance or fitting (production type).

1.3. The manufacturer shall lodge an application for EU type-examination with a single notified body of his choice.

1.3.1. The application shall include the following:

- (a) the name and address of the manufacturer and, if the application is lodged by the authorised representative, his name and address as well;
- (b) a written declaration that the same application has not been lodged with any other notified body;
- (c) the technical documentation. The technical documentation shall make it possible to assess the appliance's or fitting's conformity with the applicable requirements of this Regulation and shall include an adequate analysis and assessment of the risk(s). The technical documentation shall specify the applicable requirements and cover, as far as relevant for the assessment, the design, manufacture and operation of the appliance or the fitting. The technical documentation shall contain, wherever applicable, at least the following elements:
 - (1) a general description of the appliance or the fitting;
 - (2) conceptual design and manufacturing drawings and schemes of components, sub-assemblies, circuits, etc.;
 - (3) descriptions and explanations necessary for the understanding of those drawings and schemes and the operation of the appliance or the fitting;



- (4) a list of the harmonised standards applied in full or in part the references of which have been published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo and the Official Journal of the European Union and, where those harmonised standards have not been applied, descriptions of the solutions adopted to meet the essential requirements of this Regulation, including a list of other relevant technical specifications applied. In the event of partly applied harmonised standards, the technical documentation shall specify the parts which have been applied;
 - (5) results of design calculations made, examinations carried out, etc.;
 - (6) test reports;
 - (7) instructions for installation and use of the appliance;
 - (8) the EU declaration of conformity of the fitting containing the instructions on how the fitting should be incorporated into an appliance or assembled to constitute an appliance;
- (d) the specimens representative of the production envisaged. The notified body may request further specimens where needed for carrying out the test programme;
- (e) the supporting evidence for the adequacy of the technical design solution. This supporting evidence shall mention any documents that have been used, in particular where the relevant harmonised standards have not been applied in full. The supporting evidence shall include, where necessary, the results of tests carried out in accordance with other relevant technical specifications by the appropriate laboratory of the manufacturer, or by another testing laboratory on his behalf and under his responsibility.
- 1.3.2. Where appropriate, the manufacturer shall also submit to the notified body the following documents:
- (a) the EU type-examination certificate and the EU declaration of conformity relating to the fittings incorporated into the appliance;
 - (b) attestations and certificates relating to the methods of manufacture and/or inspection and/or monitoring of the appliance or the fitting;
 - (c) any other document making it possible for the notified body to improve its assessment.
- 1.4. The notified body shall:
- For the appliance or the fitting:



1.4.1. examine the technical documentation and supporting evidence to assess the adequacy of the technical design of the appliance or the fitting.

For the specimen(s):

